

**Udherrefyesi (UPK) ne lidhje me
epidemiologjine, elementet klinike,
diagnostikimin dhe mjekimin e Hepatiteve
Virale Akute.**

Data e publikimit: më dhjetor 2010
Data e rivlerësimit: sipas nevojes

ANËTARËT E GRUPIT TE PUNES PËR HARTIMIN E UDHËRRËFYESVE

Urdher nr_203 date 09.04.2010 “per ngritjen e Grupit te Punes per perqatitjen e “Udhezuesve te praktikes mjeksore dhe protokollove klinike per Sherbimin e Infektivit, Ministri i Shendetit Z.Petrit Vasili.

| | | |
|------------------|----------|-------|
| Dhimiter Kraja | kryetar | QSUT |
| Kozma Tavanxhi | anetar | QSUT |
| Silva Bino | anetar | QSUT |
| Arjan Harxhi | anetar | QSUT |
| Najada Como | anetar | QSUT |
| Arben Pilaca | anetar | QSUT |
| Klodiana Shkurti | anetar | QSUT |
| Arben Ndreu | anetar | QSUT |
| Entela Kolovani | sekretar | QSUT |
| Mirela CELA | anetar | QKCSA |
| Brikena Dedo | anetar | MSH |
| Xhadi Gjana | anetar | ISKSH |

| Pasqyra e lëndës | Faqe |
|--|-------------|
| Parathënie | 5 |
| Objektivi | 6 |
| Përfituesit e këtij udhërrëfyesit | 8 |
| Falenderime | 9 |
| Grupi i punes | 9 |
| Etiologjia, Epidemiologjia dhe Klinika | 10 |
| Hepatiti Viral A | 10 |
| Hepatiti Viral B | 11 |
| Hepatiti Viral C | 12 |
| Hepatiti Viral D | 13 |
| Hepatiti Viral E | 14 |
| Diagnoza laboratorike e hepatiteve virale akute | 15 |
| Shkaqet bakteriale te hepatiteve. | 16 |
| Viruset hepatotrope minore. | 17 |
| Viruset hepatotrope madhore | 20 |
| Shkaqet tokrike te hepatiteve. | 21 |
| Shkaqe te tjera te demtimeve hepatike | 21 |
| Trajtimi dhe parandalimi i hepatiteve virale akute | 22 |
| Trajtimi dhe parandalimi i Hepatitit A | 22 |
| Trajtimi i Hepatitit B | 23 |
| Terapi antivirale ne hepatitin B kronik | 23 |
| Trajtimi i hepatitit C | 25 |
| Hepatitis C akut | 25 |
| Hepatiti C kronik | 25 |
| REFERENCAT | 26 |

| Pasqyra e tabelave | faqe |
|---|-------------|
| 1. Tabela 1. Sistemi gradues për llojin e rekandimit në udhërrëfyesit klinik | 7 |
| 2. Tabela Nr. 2. Evolucioni serologjik i HVA | 16 |
| 3. Tabela Nr.3. Infeksioni akut i HVB dhe evolucioni serologjik i tij | 18 |
| 4. Tabela Nr.4. Serologjia e infekzionit akut nga HVC dhe e sherimit prej tij | 18 |
| 5. Tabela Nr.5. Infeksioni akut nga HVC dhe evolucioni i tij drejt kroniçizimit | 19 |
| 6. Tabela Nr.6. Evolucioni serologjik drejt kroniçizimit te HVB | 19 |
| 7. Tabela Nr.7. Shembulli kuptimor i serologjise se HVB | 20 |

Shkurttime:

HVA = Hepatiti viral A
HVB = Hepati viral B
HVC = Hepatiti viral C
HVD = Hepatiti viral D
HVE = Hepatit viral E
HVG = Hepatiti viral G
SI = Sëmundjeve Infektive
FA = Fosfataza alkaline
AST = Aspartat Aminotransferaze
ALT = Alanine Aminotransferaze
GGT = Gamma Glutamil Transferaza
LDH = Laktat Dehidrogenaza
AIDS= Syndroma e Imunodeficencës së Fituar
C.T = Tomografia e Kompjuterizuar
C.M.V. = Cytomegalovirus
E.B.V= Virusi i Epstein-Barr (i Mononukleozës Infektive)
HIV= Virus i Imunodeficencës Humane
mg = Miligram
mcg/kg = Mikrogram per kilogram peshe
KID = Koagulimi Intravaskular i Diseminuar
R.M.N = Rezonancë Manjetike Nukleare
SED= Sedimentacioni eritrocitar
V.H.S. = Viruset e Herpesit Simplex
V.H.Z. =virus i varicela- Herpes Zoster
QEV = Qendra e Edukimit ne Vazhdim

Parathënie

Hepatitis do te thote “inflamacion i melçise”, dhe shkaku me i zakonshem te ketij fenomeni eshte infekzioni i organizmit human me nje prej 5 (pese) virusave te quajtura Hepatiti viral A (HVA), Hepati viral B (HVB), Hepatiti viral C (HVC), Hepatiti viral D (HVD) dhe Hepatit viral E (HVE), por vetem tre prej tyre HVA, HVB dhe HVC shkaktojne pothuajse 90% te rasteve te ketij infekzioni.

Te gjitha keto virus mundet qe te shkaktojne ne organizmin tone nje semundje akute me simptoma, qe zgjasin disa jave duke perfshire: zverdhjen e lekures dhe te syve (ikterin), urina e erret, lodhja e skajeshme, te perzierat, te vjellat dhe dhimbjet abdominale.

Mundet shpesh qe te duhen muaj deri ne nje vit, qe person i infektuar te ndihet plotesisht i sheruar.

Vlersimet sugjerojne qe ne te tere boten ka 385 milion bartes te HVB dhe 170 milion bartes te HVC. Me shume se 1 milion vdekje te cilat ndodhin perçdo vit ne bote, i atribuohen aktualisht HVB.

Transmetimi i ketyre virusave eshte: (1) kryesisht fekal-oral per HVA dhe HVE, (2) perkutan per HVB, HVC dhe HVD, si dhe (3) seksual per HVB.

Dekursi i semundjes mundet qe te jetë edhe: (a) fulminant (p.sh. HVE ne shtatezani), (b) ose nje infekzion kronik si dhe me sekela te renda çka ndodh per HVB, HVC dhe HVD.

Masat parandaluese ndaj Hepatiteve Viral Akute perfshijne hemotransfuzionin e sigurte, perdonimin e sigurte te injeksioneve, promovimin e praktikave te seksit te sigurte, dhe imunizimin (per HVA dhe HVB).

HVB eshte targetuar prej OSH-se per te reduktuar incidenten/prevalencen e tij me ane te progamit te vaksinimit te femijeve te moshes nen 1 vjeç.

Objektivi

Ky Udhherrefyes ka per qellim kryesor te jape nje ndihmese domethenese ne kuptimin e drejte te problemit qe perbejne per Shendetit Publik Shqiptar numuri i madh e i pervitshem i rasteve me Hepatite Virale Akute, rrezikshmerine e perhapjes se shpejte dhe masive te tyre ne popullate, pasojat afat – shkurtera dhe afat – gjata te tyre si ne aspektin e shendetit individual, po ashtu edhe ne kuadrin e “kornizes” socio – ekonomike te ketyre pasojave, per te bere te mundur ne fund te fundit qe nepermjet bashkepunimit shume – hallkezor te mjedisit mjekosr Shqiptar te realizohet ne kohe dhe me sukses parandalimi, zbulimi dhe trajtimi i personit apo grup - personave te infektuar nga viruset ne fjale.

Udhherrefyesi (UPK) ne lidhje me epidemiologjine, elementet klinike, diagnostikimin dhe mjekimin e Hepatiteve Virale Akute është pergatitur nga një grup ekspertesh të Sëmundjeve Infektive (SI) të Shqipërisë. Udhëzuesi yne është mbështetur në udhëzueset e meparshem te pergatitura nga ekspertët e sëmundjeve infektive Amerikanë, Kanadeze, Franceze dhe Britanike, si dhe ka per objektiv thelbesor përdorimin e tij sa me racional nga personeli shëndetësor i te gjitha niveleve te perkujdesit shendetosr ne vendin tone, personel i cili ne vijimesi kujdeset per parandalimin, diagnostikimin, mjekimin dhe ndjekjen ne dinamike te te semureve me Hepatite Virale Akute.

Udhërrëfyesi përfshin të dhëna te koncentruara mbi me epidemiologjine, elementet klinike, diagnostikimin, mjekimin e parandalimin e Hepatiteve Virale Akute.

Në tabelën e mëposhtme (Nr1), ne kemi bere përshtatjen e sistemit të gradës për fortësinë e rekomandimit, sistem i cili na ndihmon në ilustrimin e metodave, mënyrave dhe mjekimeve të përshkruar në këtë udhërrëfyes. Ky system është i përshtatur nga sistemi i miratuar nga Shoqata e Infeksionistëve Amerikane dhe i aprovuar nga Shoqata e Infeksionisteve të Shqipërisë

***Kategoria, grada
Fortësia e rekomandimit***

Definicioni

| | |
|---|---|
| A | Evidencë e fortë në mbështetje të një rekomandimi |
| B | Evidencë e mirë në mbështetje të një rekomandimi |
| C | Evidencë e dobët në mbështetje të një rekomandimi |

Cilesija e evidencës

| | |
|-----|--|
| I | Evidencë e mbështetur nga >1 se nje studim i randomizuar apo i kontrolluar |
| II | Evidencë e mbështetur nga >1 studime klinike, te pa randomizuara Nga studime analitike kohorte apo kontroll rastesh (preferohen 11 qendra); |
| III | Evidencë nga opinionet e autoriteteve të respektuara, të bazuara në eksperiencën klinike, studimet diskriptive apo raportimet nga ekspertet |

Përfituesit e këtij udhërrëfyesit

Udhërrëfyesi do të jetë nje material me vlere per te gjithë punonjësit e:

Shërbimit shëndetësor **paresor, dyesor dhe terciar** te perfshire direkt dhe indirekt ne menaxhimin e hallkave te ndryshme parandaluese, diagnostikuese, mjekuese dhe evolutive te hepatiteve virale akute.

Me konkretisht ai do te sherbeje ne mirformimin kliniko-menaxhues te Hepatiteve virale Akute nga:

- Mjeku i familjes
- Mjekët specialiste infekzionistë
- Specialistët e konrollit të infekzionit
- Farmacistët
- Studentet e Fakulteteve te Mjeksise, Stomatologjise apo Infermijerise
- Specialistët e mjekësisë së urgjencës
- Mjekët specialistë reanimatore
- Specialistët e shëndetit publik
- Infermierët në praktikë.
- Mjeket specializante ne fushat e Semundjeve Infektive, Gastro-Hepatologjise, Semundjeve te Brendeshme, te Emergjancave Mjeksore dhe te Mikrobiologjise Klinike.

Ky udhërrëfyes i adresohet gjithashtu edhe pacientëve në grup-mosha më të mëdha se sa mosha 14 vjeçë, te cilet perbejne objekt te “agresimit” nga viruset e ndryshme shkaktare te hepatiteve virale akut, si dhe objektin e zbatimit ne praktik te ketij Udherrefyesi, per mirkuptimin nga ana e tyre te semundjes, me qellimin final rritjen sa me te mire te shkalles se bashkpunimit mjek – pacient, si kyçi i suksesit ne miremenaxhimin e ketij problemi madhor per Shendetin tone Publik.

Falenderime

Në hartimin e këtij udhërrëfyesi kanë kontribuar disa specialistët infekzionistë të Q.S.U. “Nënë Tereza”, specialistë të Shëndetit Publik si dhe specialistët e QKCSA. Në mënyrë të vecantë duam te falenderojmë per ndihmesen dhe sugjerimet e bera: Shefin e Departamentit te Semundjeve Infektive ne SQUT, Prof Dhimiter Kraja, Prof/Asoc Tritan Kalo, DrShM Klodiana Shkurti, DrShM Entela Klovani, Dr. Ergys Ramosaço, DrShM Arben Pilaca, Dr. Edmond Puca, Dr. Ermira Muça, Dr. Shkelqim Kurti, Dr. Sabahete Dedja, Dr. Ilda Tare dhe DShM Silvana Zotaj – Novi.

Etiologjia, Epidemiologjia dhe Klinika

Hepatiti Viral A

Hepatiti A, një prej semundjeve me te vjetra te njoitura te njeriu, eshte një semundje e vetizoluar e cila rezulton ne hepatit fulminant dhe vdekje vetem ne një pjese shume te vogel te pacienteve te prekur prej tij. Megjithate kjo semundje eshte një shkak i rendesishem i morbozitetit dhe i humbjeve socio-ekonomike ne shume pjese te botes.

Transmetimi i HVA ndodh tipikisht me rrugen fekal-orale. Ky infektim ndodh heret ne jete ne zonat ku sanizimi eshte i varfer si dhe kushtet e jeteses jane ato te nje zone te mbipopulluar. Me permirsimin e sanizmit dhe higjenes, infekzioni vonohet dhe si rrjedhim edhe numuri i personave te ndjeshem ndaj semundjes rritet. Ne keto kushte shperthimet epidemike mundet te vijne edhe prej kontaminimit fekal nga nje burim i vetem.

Hepatiti Viral A me pare eshte quajtur edhe si Hepati infeksioz, Hepatiti epidemik, Ikteri epidemik ose Ikteri kataral.

Hepatiti Viral A (HVA) shkaktohet prej vrusit te HVA, nje ARN virus i pambeshtjelle, i zbuluar per here te pare me 1973, dhe i klasifikuar ne gjinine e Hepatovirus te familjes se Picornavirus.

Ndersa raportohen 1.5 milion raste per çdo vit te HVA, incidenca e vertete duket te jete shume me e madhe. Virusi perhapet pothuajse gjithmone permes rruges fekal-orale ose nga kontakti direkt me personat e infektuar ose indirekt permes gelltites te ushqimeve ose ujit te kontaminuar nga feçet humane, veçanerisht nga konsumimi i guaskave te detit pak ose aspak te gatuara. Virusi mundet te mbijetoje ne nje gjendje te thate per se paku nje javë ne kushtet e mjedisit si dhe mundet te mbijetoje ne uje deri ne 10 (dhjete) muaj. Transmetimi nga personi te personi, duke perfshire edhe rrugen seksuale, eshte nje tjeter menyre e transmetimit.

HVA eshte nje semundje e parandalueshme me ane te vaksinimit kundrejt ketij virusi.

Periudha e inkubacionit te HVA eshte 15 deri ne 50 dite, me nje mesatare prej 28 ditesh. Semundja qe rezulton nga nje infektion i tille manifestohet me anoreksi, nauzea, lodhje, temperature dhe ikter si ne te rritur po ashtu edhe ne femijet e rritur. Virusi eshte i pranishem ne lengun biliar, ne gjak, ne feçe dhe ne melçi gjate faze se voneshme te inkubacionit si dhe ne fazen e hereshme akute te semundjes. Periudha e infeksiozitetit eshte e variueshme por tipikisht ndodh 2 javë para fillimit te simptomave deri ne nje javë pas fillimit te ikterit. Gjate kesaj kohe virusi ekskretohet ne feçe. Strehimi i virusit mundet te jete shume me i zgjatur ne personat me imunitet te komprometuar.

Mesatarja e zgjatjes se semundjes eshte 1 muaj, por keputshmerija mundet te zgjase deri ne 12 muaj. Semundjet me serioze me nekroze hepatike, insufisience fulminante hepatike dhe vdekja jane jo te zakoneshme. Megjithate, rrezikshmerija e semundjes eshte e larte ne ata me semundje kronike pre-ekzistuese te heparit dhe mvaret prej moshes; perqindja e fatalitetit midis te rriturve > 40 vjeç eshte se paku 2% me nje rritje deri ne $> 10\%$ midis individive te hospitalizuar te moshes > 60 vjeç.

Semundja eshte zakonisht asimptomatike ne femijet e vegjel dhe mundet gabimisht te miret per grip ose nje dobesi e per gjitheshme. Megjithate, keta femije mundet te strehojnë virusin per disa muaj dhe per kete aresye te behen nje rezervuar eficient ne perhapjen e HVA ne subjektet e ndjeshem perreth tyre.

Hepatiti Viral B

Hepatiti viral B (HVB) eshte nje problem i madh i shendetit publik. Afersisht 30% e popullates boterore, pra 2 bilion persona, kane te dhena serologjike per infektimin nga HVB. Eshte vlersuar se 350 milion prej tyre kane nje infeksion kronik prej HVB, rreth 1 milion prej te cileve vdesin per çdo vit prej semundjeve kronike te melçise duke perfshire cirrozen dhe kancerin e melçise. 40 milion persona jane bartes kronike te HVB. Vete HVB eshte njohur si kancerogjeni human i dyti pas duhanit.

Nje vaksine e vlefshme kunder HVB eshte ne dispozicion qe prej vitit 1982. OSHB rekomandon qe vaksina kunder HVB te perfshihet ne kalendarin e vaksinimit rutine te femijeve te te gjithe botes.

HVB eshte nje virus me ADN i familjes se Hepadnaviridae. Endemiciteti i infeksionit prej HVB varion shume ne bote dhe influencohet primarisht prej moshes ne te cilen ndodh infeksioni. Ne Europe niveli i endemicitetit rritet prej veriut ne jug dhe prej perendimit ne lindje. Shumica e vendeve te Europes Veriore dhe Perendimore kane nje nivel te ulet prevalence te infeksionit nga HVB (me pak se 0.5% e popullates eshte pozitive per HBsAg).

Nje prevalence papritshmerisht e larte e bartesve te HVB (5% - 12%) eshte gjetur ne shume pjese te Europes Qendrore dhe Lindore si dhe vendet e ish Bashkimit Sovjetik. Endemiciteti eshte konsideruar i larte ku se paku 8% e popullates eshte HBsAg pozitive). Prania e nje ose me shume markuesve serike te infektimit prej HVB si dhe perqindja e larte e infektimit ne femijet e moshes prej 1 deri ne 10 vjeç, konfirmon natyren endemike te ketij virusi ne Shqiperi. Te dhenat tregojne se ka nje reduktim te prevalences se HBsAg ne popullaten e per gjitheshme te pavaksinuar shqiptare prej 18% - 19% (para vitit 1995), ne 9.5% (pas vitit 2005, pra rreth 10 vjet pas introduktimit te vaksinimit te detyrueshem te te porsalindurve dhe grupeve te riskut per HVB ne vendin tone.)

Virusi transmetohet permes rrugeve te ndryshme duke perfshire transemtimin perinatal, trasmetimin perkutan si dhe nga personi te personi prej kontakteve intime (seksuale ose jo). Pothuajse te gjitha infeksionet ndodhin ose gjate periudhes perinatale ose heret ne femijeri, te cilat jane perjegjese per perqindjet e larta te infektimit kronik nga HVB ne keto popullata.

Personat e infektuar me HVB kane si “eleminim afatshkurter” po ashtu edhe “afatgjate” te ketij virusi nga organizmat e tyre, çka perkthehet me ecurine akute ose kronike te infektimit nga ky virus ne personat ne fjale.

Periudha e inkubacionit pas infektimit eshte zakonisht 3 - 4 muaj, qe varion prej 6 javë deri ne 6 muaj. Me tu infektuar nga HVB, nje person mundet qe te kete qofte semundje simptomatike (HVB akut), qofte nje infeksion asimptomatik pa shenja ose simptoma te semundjes. Ne cilindo rast, personi i nfektuar mundet qe te sherohet prej infektimit dhe

te zhvilloje nje imunitet te perjetshem, ose te zhvilloje nje infektion kronik qe edhe ai zakonisht zgjat gjate gjithe jetes. Keta persona nuk ndihen te semure per dekada te tera pas infektimit nga HVB. Per fat te keq 90% e femijeve te lindur nga nena bartese te HVB kane nje shans te madh per te zhvilluar nje HVB kronik gjate jetes se tyre. Rreth 25% e te infektuarve kronik ne femijeri dhe rreth 15% e te infektuarve kronike ne moshe me te madhe, vdesin prej kanceri ose cirrozes se heparit. Rreth 1-2% e personave me HVB akut vdesin nga format fulminante te ecurise se ketij infektimi.

Hepatiti Viral C

Me 1989 virusi perqejjes per shumicen e hepatiteve post-transfuzionale u identifikua dhe u klonua (HVC). Hepatiti viral C shkaktohet nga nje virus i mveshur, me ARN nje fijeze pozitivisht te perdredhur, i familjes se Flaviviridae, gjinia Hepacivirus. Hepatiti Viral C njihet ndryshe edhe si tipi C i hepatiteve virale akute, Hepatiti non-A non B i transmetuar parenteralisht (PT-NANB), Hepatiti non-A non-B post transfuzional.

Infekzioni nga HVC eshte i zakonshem ne te gjithe boten. Vlersohet se rreth 3% e popullates boterore (afersisht 123 deri ne 170 milion persona) ka HCV. Ka rreth 4 milion bartes te HVC vetem ne Europe.

HVC eshte bere nje problem globalisht me serioz se HVB, sepse ai eshte perqejjes per 2/3 e vdekjeve nga semundjet kronike te heparit, si dhe ka me shume gjasa te evoluojе drejt karcinomes hepatocelulare ne krahasim me HVB, si dhe ne dallim nga ky i fundit i cili sot edhe parandalohet me perdonimin e vaksines, HVC nuk mundet te parandalohet me ane te imunizimit te popullates ne mungese te nje vaksine te vlefshme ndaj ketij infeksioni.

Hepatiti viral C perhapet zakonisht nga ndarja e shiringave te infektuara me nje person te infektuar, nga marrja e gjakut te infektuar ose prej ekspozimit aksidental perkundrejt gjakut te infektuar. Transmetimi nga nena te femija eshte tashme e mire dokumentuar, por eshte jo e zakoneshme. Nje person me HVC mundet qe te infektohet prej tipeve te tjera te hepatiteve virale si HVA ose HVB.

Virusi infekton qelizat hepatike dhe mundet te shkaktoje inflamacion te rende te tyre me duke zhvilluar hepatite akute, hepatite kronike dhe cirroza. HCV eshte perqejjes per afersisht 70% te te gjitha karcinomave hepatocelulare.

Periudha e inkubacionit varion nga 2 jave deri ne 6 muaj, zakonisht nga 6 deri ne 9 jave. Fillimi i semundjes eshte i pa dallueshem nga infekzionet e shkaktuara prej viruseve te tjera hepatotrope, zakonisht i pa zeshem me anoreksi, nje diskonfort abdominal te lehte, nausea dhe te vjella, ethe dhe lodhje, qe progresojne drejt ikterit ne rreth 25% te rasteve, pra me pak se ne HVB.

Megjithse 60% deri ne 90% e personave te infektuar mundet te jene fillimisht asimptomatik, HVC kronik ndodh ne 50% deri ne 80% te tyre.

Shumica e udhetare ne zonat endemike me infekzionet nga HVA, HVB dhe HVC pas kthimit prej ketyre zoanve jane te infektuar me HVA (60%), HVB (15%) dhe HVC (25%).

Hepatiti Viral D

Me 1977 u zbulua ne hepatocidet e pacienteve me HVB kronik nje antigen berthamor i pa njobur me pare, qe i perngjante HBcAg. U emertua si “antigeni delta”, dhe pranija e tij ishte gjithmone e shoqeruar me infektimin nga HVB. Me 1980 u zbulua se “antigeni delta” ishte komponent i nje virusi te ri defektuez, i cili kerkonte bashkinfektimin me HVB per tu replikuar. HVD eshte nje virus defektive me ARN, i shoqeruar me hepatite te renda ose fulminante kur ndodh si mbinfeksion ne nje person te infektuar me pare nga HVB.

Vlersohet se ne te gjithe boten ka rreth 15 milion individe te infektuar me HVD, kryesisht ne vendet me prevalence te larte si Italia, pjesa te Europees Lindore, pellgu i Amazonise, Kolumbi, Venezuela, Azia Perendimore si dhe disa Ishuj te Oqeanit Pacifik.

Menyrat e transmetimit jane te njejtë si ato te HVB, me predominim te transmetimit me ane te shiringave te perdonuesit e drogave. Prevalanca e HVD ne perdonuesit te droges te infektuar me pare me HVB, eshte raportuar qe te jete midis 31% deri ne 91% te tyre. Perqindja e transmetimit seksual te HVD konsiderohet te jete e ulet.

Periudha e inkubacionit te HVD varion midis 2 deri ne 8 javë. Semundja qe rezulton nga ky infeksion ka nje fillim te vrullshem te nje hepatiti fulminant ne nje individ te ko-infektuar me HVB. Periudha dhe shkalla e infeksiozitetit te HVD nuk jane te njobura,

Ne Europe dhe ne SHBA, 25% deri ne 50% te hepatiteve fulminante ne rastet e infektiveve prej HVB, jane te shoqeruara me ko-infeksionin nga HVD.

Shkalla e imunitetit te vijim te infektimit nga HVD nuk njihet, dhe infektiviteti mundet te persistojte per gjithe jetes, edhe ne mungese te nje viremije te mateshme.

Hepatiti Viral E

Hepatiti viral E (HVE) nuk ishte e njobur si nje semundje e veçante humane deri me 1978 gjate nje shperthimi epidemik ne Indi. Te dhenat e para eksperimentale per pranine e nje agjenti tjeter shkaktues te hepatiteve me perhapje ujore u raportua me 1983. HVE njihet ndryshe edhe si Hepatiti non-A non-B i transmetuar ne menyre enterale, Hepatiti epidemik non-A non-B, ose Hepatiti fekal-oral non-A non-B, dhe u pa qe ky virus eshte shkaku kryesor i formave sporadike te rasteve me hepatit ne zonat endemike te infeksionit.

Hepatitit viral E shkaktohet prej nje virusi me nje zinxhir te vetem ARN-je pozitivisht te perdredhur. Fillimisht i klasifikuar si anetar i familjes se Caliciviridae, sot HVE eshte i pa klasifikuar.

Sikurse HVA, edhe HVE transmetohet nga nje person ne tjetrin ne rrugen fekal-orale. HVE eshte nje semundje me perhapje ujore prej kontaminimit te ujit ose ushqimeve, duke shkaktuar edhe shperthime te medha te tija. Personat qe kurre nuk kane qene ne kontakt me HVE jane me te riskuar ndaj ketij infeksioni. Transmetimi direkt nga nje person i infektuar te nje tjeter nuk eshte e zakoneshme. Transmetimi vertikal prej nenes te fetusi ose femija eshte pershkruar ne literature.

Eshte e mundeshme nje perhapje zoonike e HVE, perderisa disa primate jo humane si majmunet, derrat, lopet, delet, dhite dhe brejtesit, jane te ndjeshem ndaj ketij infeksioni.

HVE eshte shkaku kryesor i shperthimeve epidemike te hepatiteve enterike ne te gjithe boten. Perhapja e HVE ne forma epidemike te tijat jane raportuar sot ne Afrike, Azine Jugore, Azine Jug-Lindore, Kine, Lindjen e Mesme, Meksike, Greqi dhe Rusi. Azija Jugore dhe Jug-Lindore duket qe kane nje endemicitet te laret te HVE.

Periudha e inkubacionit per HVE varion nga 15 deri ne 64 dite. Semundja qe vijon infektimin prej tij eshte e ngjashme me HVA. Perqindja e fateliteteve midis te rriturve eshte po ashtu e ngjashme me ato te HVA (0.5% deri ne 2%), por midis grave ne tremujorin e trete te shtatezanise ky mortalitet rritet deri ne 20%.

Periudha e infeksiozitetit nuk njihet, por virusi eshte zbuluar ne fece per gjate 4 javave qe vijojne konsumimin e ujit te kontaminuar.

DIAGNOZA LABORATORIKE E HEPATITEVE VIRALE AKUTE

Megjithese shenjat dhe simptomat e hepatiteve virale akute jane shpesh jo specifike, ekzaminimet laboratorike jane mjaft karakteristike.

Ne hepatitin akut viral niveli i Aspartat Aminotransferaze (AST ose SGOT) dhe Alanine Aminotransferaze (ALT ose SGPT), jane zakonisht me shume se tete here mbi vleren e normes ne kohen kur shfaqet ikteri. Raporti AST/ALT (Indeksi De Ritis) eshte zakonisht <1 ne hepatitet virale, ndersa > 1.5 ne semundjet alkoolike te melcise.

Fosfataza alkaline (FA), Gamma Glutamil Transferaza (GGT) dhe Laktat Dehidrogenaza (LDH) jane lethesisht te rritura ne hepatitet virale akute. Interpretimi i enzimave hepatike nuk specifikon nese shkaku eshte hepatit viral, veprim hepatotoksiq i barnave, toksine ose nje demtim jo specifik i melcise p.sh: nga anoksia, shoku ose insuficiencia e rende e zemres.

Niveli i AST dhe ALT rriten gjate fazes preikterike te hepatiteve virale duke arritur kulmin ne fillim te fazes ikterike. Ne periudhen e sherimit niveli i aminotransferazave bie shpejt, por mbetet lethesisht jo normal per disa jave pasi ikteri dhe simptomat jane normalizuar.

Niveli i bilirubines rritet ne fazen ikterike te hepatiteve virale, ne te dy fraksionet direkt dhe indirekt ne raporte afersisht te barabarte. Rritjet e perqendrimit te bilirubines direkte sugjerojne kolestaze, kurse te asaj indirekte sugjeron hemolize.

Koha e protrombines eshte zakonisht normale ne hepatitet virale akute, kur ajo rritet tregon nekroze te rende te melcise qe mund te progrejoje ne insuficience hepatike fulminante. Cdo rritje e kohes se protrombines duhet te konsiderohet si shenje serioze ne securine e nje hepatiti.

Nivelet e albumines, globulines dhe hemoglobines jane zakonisht normale ne hepatitet virale akute.

Leukocitet jane ose normale, ose lethesisht te uleta me nje limfocitoze te lehte. Trombocitet mbeten normal, pervec rasteve te hepatitit fulminant, ne te cilin mund te zhvillohet KID.

- Viruset hepatotrophe madhore.

Mjaft raste te hepatiteve akute shkaktohen nga agjente virale, sic jane viruset e hepatiteve A, B, C, D, E. Ndersa keto agjente jane virologjikisht te ndare, shenjat klinike jane mjaft te ngjashme.

1. Pacienti qe eshte dyshuar per hepatit viral duhet te testohet per anti HAV IgM, HbsAg, anti HBc IgM, anti HCV. Prezenca e anti HAV IgM vendos diagnozen e hepatitit viral A.




Tabela Nr. 2: Evolucioni serologjik tipik i HVA

2. Prezenca e HbsAg sugjeron pranine e infekzionit nga virusi B por nuk differencon semundjen akute nga kronike. Prezenca e anti HBC IgM konfirmon diagnozen e hepatitit akut B, mungesa tregon qe pacienti eshte nje mbartes kronik i HbsAg dhe qe hepatiti i shfaqur eshte ose acarim i hepatitit kronik B ose nga mbiinfekzioni me nje agjent tjeter.




Tabela Nr.3. Infekzioni akut i HVB dhe evolucioni serologjik i tij

3. Anti- HDV gjendet vetem tek personat HbsAg + si coinfeksion, por nuk specifikon nese eshte mbiinfeksion akut apo kronik.

4. Hepatiti C mund te diagnostikohet ne baze te trupave HCV, megjithese prania e ketyre antitrupave nuk ndan nje infeksion akut nga nje kronik. Per shkak te natyres fluktuante te transaminazave qe shihen ne hepatitin C, eshte e veshtire te percaktohet klinikisht nese pacienti eshte i infektuar rishtas apo ka acarime te semundjes kronike, sidomos kur nuk gjendet burimi i infeksionit (sic eshte gjaku i infektuar).

Provati e gjeneracionit te pare jane jo te ndjeshme ne diagnozen e infeksionit akut dhe shpesh nuk percaktojne antitrupat 6-8 muaj pasi infeksioni ka ndodhur.

Provati e gjeneracionit te dyte kane shkurtuar periudhen ne 8-12 javë. Pacientet mund te kene antikorpe negative gjate fazes fillestare te infeksionit akut dhe duhen ritestuar 3-6 muaj me vone, nqs dyshimi ekziston.

Per shkak te incidences se larte te kronocitetit te lidhur me hepatitin C, pacientet e infektuar duhet te ndiqen pas 6-12 muajsh, nese kane zhvilluar hepatiti kronik C. PCR eshte ekzaminimi me sensititet per te percaktuar pranine dhe sasine e ARN virale te HCV.




Tabela Nr.4. Serologjia e infeksionit akut nga HVC dhe e sherimit prej tij




Tabela Nr.5. Infekzioni akut nga HVC dhe evolucioni i tij drejt kroniqizimit

5. Antirupat anti-HEV tregojne pranine e virusit te hepatitit A (veçanërisht e domosdoshme tek grata shtatezena per shkak te agresivitetit te tij tek keto subjekte).

Hepatiti kronik i riacaruar mund te imitoje hepatitin viral akut. Personat HbsAg pozitiv, (anti HBc IgM negativ) mund te shfaqin simptoma ikteri dhe rritje te moderuar te aminotransferazave, rritje te globulines dhe pakesim te niveleve te albumines.

Prezenca e simptomave ose e enzimave jo normale per me shume se 6 muaj indikon nje hepatit kronik. Biopsia hepatike eshte e dobishme per te percaktuar ashpersine dhe agresivitetin e procesit inflamator hepatik. PCR-HBV DNA percakton nga ana sasiore dhe cilesore pranine e virusit te hepatitit B.




Tabela Nr.6. Evolucioni serologjik drejt kroniçizimit te HVB

Serologic Patterns in HBV

| Disease State | HbsAg | HBsAb | HBcIgG | HBcIgM | HBeAg | HBeAb |
|--------------------|-------|-------|--------|--------|-------|-------|
| Incubating | + | - | - | - | +/- | - |
| Acute Hepatitis | + | - | + | + | + | - |
| Chronic Carrier | + | - | + | +/- | - | + |
| Chronic Hepatitis | + | - | + | +/- | + | - |
| Resolved Hepatitis | - | +/- | +/- | - | - | - |
| Vaccine | - | + | - | - | - | - |

Tabela Nr.7. Shembulli kuptimor i serologjise se HVB

Viruset hepatotrope minore.

Hepatiti akut mund te shkaktohet edhe nga viruse te tjera, ku prekja hepatike zakonisht eshte e lehte, e vetekufizuar ose subklinike.

1. Nga viruset e lartpermendura eshte EBV shkaktari i mononukleozes infektive. Infekzioni nga EBV-ja mund te manifestohet si hepatit akut ikterik, pa shenjat e zakonshme te mononukleozes infektive. Disa vecori te hepatitit sugjerojne se ai shkaktohet nga infekzioni nga EBV. Se pari, temperatura eshte me e larte dhe me e vazhdueshme ne fazen ikterike; se dyti, nivelet e FA dhe LDH jane zakonisht me te larta sec priten nga niveli i ngritjes se ikterit dhe aminotransferazave. Me sugjesteive eshte limfocitoza $> 50\%$ me limfocite atipike $> 20\%$. Konfirmimi absolut i mononukleozes infektive eshte shfaqja e anti-EBV IgM.
2. Roli i infekzionit CMV si shkak i hepatitit tek te rriturit eshte akoma shkak i debateve vecanerisht kur ajo lidhet me hepatitet transfuzionale. Infekzioni primar nga CMV mund te shkaktoje nje sindrome mononukleozike te shoqeruar me hepatosplenomegali dhe ngritje te lehta te niveleve te aminotransferazave, nje limfocitoze tipike, anti-CMV IgM +, rritje te titrave anti-CMV IgG, ose ekskretim i virusit ne gjak, urine ose sekrecionet oroforingale.
3. Disa virusa te tjera si viruset qe shkaktojnë rubeolen, fruthin, coxsackie B, virusi herpes simpleks, virusi varicela-zoster, virusi i etheve te verdha mund te shkaktojnë crregullime te lehta te enzimave te melcise duke manifestuar shpesh shenjat e infekzioni te gjeneralizuar. Keto ndryshime rralle shoqerohen nga ikteri. Diagnoza e ketyre infeksioneve behet nga rritja sinjifikante e titrit te antitrupave ose nga izolimi i virusit ne gjak.

Shkaqet bakteriale te hepatiteve.

Shkaqe te hepatiteve akute perfshijne infeksionet bakteriale pneumoni pneumokoksike, leptospiroza, mykobakterie (TBC pulmonar ose miliar), rikecioza, bruceloza, tularemia, pesta, sepsisi bakterial, legioneloza dhe disa fungje.

Tre agjentet infeksioze qe manifestojne sindrom hepatitik jane: sifilizi, leptospiroza dhe ethja Q:

1. Sifilizi ne stadin primar dhe ate sekondar mund te shoqerohet me ikter, rritje te aminotransferazave dhe FA. Diagnoza behet nga prania e shankrit ose rashit dhe konfirmimi laboratorik me VDRL dhe antitrupat fluorescent anti-treponeme.
2. Leptospiroza mund te shkaktoje ikter me teper si rezultat i defekteve te ekskpcionit te bilirubines, se sa i nekrozes hepatike. Diagnoza vec shenjave klinike te mbeshtetura dhe nga te dhenat klinike e epidemiologjike konfirmohet nga prania e aglutininave leptospirozike (RMAL, ELISA IgM pozitiv).
3. Ethja Q e shkaktuar nga Coxiella burneti mund te shkaktoje nje hepatit subklinik, ndonjehere te pa shoqeruar me pneumoni. Testet e prekjes hepatike jane me te moderuara se ne hepatitet virale dhe konfirmimi behet nga rritja e titrave te aglutininave kunder Coxiella burneti.

Shkaqet tokrike te hepatiteve.

Diagnoza diferenciale e hepatiteve virale shpesh duhet te behet me hepatitet medikamentoze. Cdo pacient duhet te pytet me kujdes per barnat e perdonura pasi demtimi hepatik mund te behet shkak i insuficences hepatike fulminante. Disa nga barnat hepatotokrike jane: aspirina, acetaminofeni, izoniazidi, rifampicina, fenitoina dhe halotani:

1. Mbidozimi nga acetaminofeni i qellimshem ose aksidental ka qene shkak i insuficences hepatike fulminante, demtimi shfaqet 2-5 dite pas mbidozimit.
2. Izoniazidi dhe rimfapicina mund te jene gjithashtu shkaqe te insuficences hepatike.
3. Demtimi hepatik nga Rimfapicina fillon brenda javes se pare te terapise, kurse ai nga Izoniazidi eshte me i zakonshem pas 1-2 muajsh. Trajtimi me keto barna duhet te nderpritet nqs shfaqen simptomat, ikteri apo kur rriten aminotransferazat.
4. Fenitoina shkakton hepatit zakonisht brenda 1-6 javesh te fillimit dhe shoqerohet edhe me ethe, rash, limfadenopati dhe eozinofili.
5. Demtimi hepatik nga Halotani shfaqet 3-14 dite pas perdonimit dhe i ngjan nje hepatiti viral te rende, ethja eshte mjaft karakteristike dhe mjaft paciente kane leukocitoze me eozinofili.
